

Mileniumi i Tretë

MËSOJMË DUKE MËSUAR



PRILL 2016



Në të gjitha orët e lëndës së Gjuhës shqipe dhe Letërsisë, nëpër të cilat kaloi dhe la gjurmë mendimi krijues i nxënësve me një intencë provuese në mënyrën e shprehjes nëpër esetë e tyre letrare, duke futur në shkrim imazhe të ndryshme që prekin në kujtesën e tyre. Këto shkrime letrare, ne i shfaqëm si pjesë e kurorëzimit të mundit me punën e nxënësve të klasave të dhjeta.




Në sistemim e punës së krijimeve të nxënësve, me theks të veçantë në mesazhe të nxjerra nga shkrime të ndryshme, nxënësit shpërfaqin fuqishëm dhe plotësisht diskursin që rezulton nga kultura e fituar në debate me tema të ndryshme, që i përgatisin për një jetë aktive. Shkrimet ndërlidhen fuqishëm me kodet tematike për ngritje të nivelit të të menduarit e të kritikuarit.

Fitore Mala

LETERSIA E VJETER SHQIPTARE


KULTURE TRADICIONALE

- Kultura tradicionale e nje populli,e nje kombi permban doket dhe zakonet,menyren e jeteses kolektive,komunikimin dhe krijimtarin gojore. Karakteristikat e perbashketa te ketyre veprimtarive jetesore e shpirtërore krijojne vecantite e nje kulture.
- Kultura gojore eshte me e hershme se e shkruar, pasi dhe vete shkrimi lindi me vone.Kultura gojore per cdo popull ka qene baza ku mbeeshtetet e gjithë letersia e shkruar.
- Letersia gojore eshte **anonime**;krijimtaria gojore kalon brez pas brezi,prandaj teksti eshte I pandryshueshem;eshte nje krijim kolektiv.
- Kurse letersia e shkruar e ka autorin e vet, tekstin e fiksuar dhe eshte krijim individual.



KANUNI I LEKE DUKAGJINIT

- Kanuni i Leke Dukagjinit është vepra më e madhe e kultures tradicionale shqiptare në fushën e jetës sociale. Kjo veper nuk është vetëm teresia e normave të së drejtës zakoneve shqiptare, por përmban palcën etnike të kombit shqiptar dhe të kultures së tij.




Vepra u botua ne Shkoder ne 1933.Ky kanun ka qene libri i jetes.

Fjala **kanun** (mase) eshte e rrenjes greko-bizantine.

Ajo shenjon kodet e pashkuara ne ate kohe ne Malesi.

Pas pushtimit te Shqiperise nga Perandoria Osmane kanuni eshte mbajtur si ligj i detyrueshem ne ato vise te krishtera.


Edhe pse vepra eshte e vjelur me dashuri e kujdes nga goja e popullit ,pikerisht ne krahinat ku keto rregulla ishin ligj i jetes, duheet te thuhet qe autori,i formes se botuar te Kanuni,eshte Gjecovi.



At Shtjefën Gjeçovi
(Mehill Kostandin Gjeçi-Kryeziu
1873 - 1929)

- Shtjefen Gjecovi lindi me 12 korrik 1874,ne Janjeve (Kosove). Ai ndoqi kolegjin franceskan ne Troshan. Me 15 gusht 1888 hyri ne urdherin Franceskan ne Kuvend te Fojnices; me pas vazhdoi studimet filozofike e teologjike ne Kuvendin e Kresheves.Pasi kreu studimet teologjike Gjecovi u be meshar me 15 korrik 1896. Ai u kthye menjehere ne Shqiperi ku dha meshen e pare ne kishen e Troshanit.

- Ky liber I kushtoi Gjecovit afro 30 vjet jete. Gjeocovi e hartoi vepren duke u mbeshtetur ne mbi 2000 faqe doreshkrim ,te cilat ai I grumbulloi ne viset e ndryshme.
- Kanuni perbehet prej 12 librave,kodifikon fusha te ndryshme te jetes ne kolektiviet ,ku hyn besimi ,prona,gjaku,ndeshkrimi.
- Ne kete veper nuk ka shpifje e fantazi.Ligjerimi shkon drejt formave te ngurtesuara, te cilat jane formulat,paragrafet,qe mbahen lehte mende dhe zbatohet ne jeten e perditshme.



KANGET KRESHNIKE

- Kanget kreshnike jane krijimet me te mocme e me te bukura te letersise gojore shqiptare.
- Duke u mbeshtetur ne strukturen e tyre epike dhe ne bemat e heronjve kryesore ka studiues qe I quajne Eposi per Mujin dhe Halilin.
- Kanget kreshnike I shohin si copa te eposit te vjeter,qe jeton I shkaperdredhur ne variante te ndryshme.
- Tek kenget kreshnike kemi pasur edhe figura mitologjike si: Oret e Zanat , deri te kohet qe I referohen Zotit.
- Tek kenget kreshnike ngritet kulti I jetes se njeriut.

- Tiparet kryesore te eposit jane: epizmi, legjendariteti dhe fryma heroike.
- Te kenget kreshnike kemi nje diskurs letrar te paster.
- Instrumenti kryesor eshte lahuta.



BALADAT

- Balada është një formë e vecantë e letërsisë gojore, në të cilën janë të përziera elementet epike e dramatike, por me zotërim të elementeve lirike.
- Emri i saj del nga fjala neolatine ballara (vallezot).
- Në qendër të baladës nuk janë temat kolektive e heroike.
- Në qendër të saj është tragjedia individuale, kurse koncepti themelor i saj është nderi ose besa e dhënë.

PERRALLAT SHQIPTARE


Perrallat janë krijime mjaft të vjetra; disa studiues mendojnë që janë mbetjetë të miteve të lashta; ato kanë një strukturë universale, çka është vetë e përbashkët për perrallat e çdo populli.


Perrallat janë forma më të gjata të prozës gojore. Ajo është një formë letrare ku ngjarja është tërësisht e trilluar.

Cilesi kryesorë i diskursit të perrallës janë Fantastika dhe e Mrekullueshmja.

LETERSIA E VJETER SHQIPTARE

Kultura shqiptare eshte nje kulture e lashte autoktone, por e shkruar relativisht vone. Ajo ndjek vazhdimesine kultures se lashte ilire dhe eshte krijuar ne nje udhekryq ngjarjesh.





Letersia e vjeter shqiptare ka kaluar neper tri faza:te cilat Cabej I quante periodha.

E para: Letersia e humanizmit ne shek.XVI, me perfaqesues kryesor Marin Barletin.

E dyta: Letersia filobiblike perfshin autoret e shekujve XVI,XVII e XVIII:Gjon Buzuku,Pjeter Budin, Frang Bardhin, Pjeter Bogdanin, Leke Matrenga, Jul Variboben dhe Pjeter Zarishin.

E treta: Letersia jofetare, laike e Vjershetareve (Bejtexhinjeve) te shek.XVIII, me perfaqesues Nazim Beratin, Hasan Zyko Kamberin, Muhamed Kycykun etj..

KULTURA E KRISHTERE

Te gjithë shkrimtaret janë fillobiblike duke qene te gjithë prifterinje. Shkrimet mbeshteten ne shkrime fetare, ne sherbesa shpirtërore.

Keni shkrimtaret:

- Pjeter Budi; I cili ka shkruar vargje shqip.
- Pjeter Bogdani; I cili ka shkruar librin origjinal shqip te sistemuar ne cikle vjershash.
- Gjon Buzuku; I cili ka shkruar lutje shqip, dhe librin e pare ne gjuhen shqipe Mesharin (1555).
- Frang Bardhi; I cili ka mbrojtur origjinen e Skenderbeut, dhe ka mbledhur fjale te urta shqip.
- Jul Variboba; I cili ka hartuar vepren letrare duke lidhur bashke temat fetare me popullore.
- Leke Matrenga dhe Jul Variboba ishin te dy arbereshe.

KULTURA E LINDJES

Ne shek. XVIII nje prodhim te vecante letrar ne shqip e bejne autoret e qendrave jugore te Shqiperise.

Autoret jane: Muhamed Kycyku nga Konispoli, Nezimi dhe Sylejman Ramazani nga Berati e Hasan Zyko Kamberi nga Kolonja krijojne trupin e kesaj letersia.



MARIN BARLETI

- Marin Barleti (rreth 1460-1513) është humanisti më i madh shqiptar, me veprën e tij "Historia e Skenderbeut" ai ka lidhur emrin e tij me atë të Skenderbeut.
- Ata ishin burra të një epoke; lidhja e tyre krijoi një model kulturor shqiptar; heroizmin jetësor dhe himnizimin letrar, që do të mbetet për 5 shekuj model mbizotërues i kultures së shkruar shqipe.
- Lindi rreth vitit 1460 në Shkodër. Në vitin 1479 ka marrë pjesë në mbrojtjen e Shkodrës gjatë rrethimit turk. Pas rënies së vendit ai shkroi veprën "Rrethimi i Shkodrës" më 1504.





- Kryevepra e tij “Historia e Skenderbeut” (1508-1510) ,kjo veper u botua ne latinisht tri here:me 1537 ne Strasburg,me 1578 ne Frankfurtdhe me 1743 ne Zagreb.
- “Historia e Skenderbeut” perbehet nga 2 pjese dhe 13 libra.

GJON BUZUKU

- Gjon Buzuku (rreth 1460-1513) eshte autori i librit te pare ne gjuhen shqipe dhe vepra e tij Meshari(1555) eshte deshmia e pare me vlere kulturore e gjuhesore.
- Vepren “Meshari” e shkroi nga 20 marsi i vitit 1554 deri me 5 janar 1555 .
- Ky liber permban Librin e oreve dhe Librin e Meshes,prandaj u quajt Meshar.Perbehet nga 188 faqe ne te cilat permbajn 154 000 fjale.



Gjon Buzuku

PJETER BUDI

- Pjeter Budi (1566-1622) është figura më e madhe e letërsisë së vjetër shqiptare pas Gjon Buzukut. Ai vlerësohet si poeti i parë shqiptar dhe shkrimtari i parë martir që luftoi deri në fund të jetës për idetë e tij atdhetare.
- Ai lindi në fshatin Gur i Bardh të Matit 1566. Në moshën 21 vjeçare u shugurua prift dhe shërbeu në Kosovë e Maqedoni.



- Pjesa më e madhe e vepres përbehet nga Dhjata e Vjetër dhe e RE.
- Por brenda saj ka pjesë biblike si:
- Litanite
- Psalmet
- Himnet.



- Ai shkroi kater vepra ,te gjitha ne Rome.
- Doktrina e Kershtene(1618)
- Rituali Roman (1621)
- Kush thote meshe keto kafshe I duhet me sherbyem(1621)
- Pascqyra e t'rrefyemit(1621)
- Vepra "Doktrina e Kershtene "u botua edhe tri here me vone (1636,1664 dhe 1868).

FRANG BARDHI

- Frang Bardhi (1606-1643) ne historine e letersise vjeter njihet si hartuesi I Fjalorit te pare shqiptar, qe eshte njekohesisht dhe vepra e pare shqipe pa permbytje fetare.
- Bardhi lindi me 1606 ne Kallmet te Zadrimes. Bardhi vdiq shume I ri .Por u dallua me veprat qe botoi sa ishte gjalle "Dictionarium latino-epiroticum"(Fjalori latinisht-shqip)ne Rome me 1635 dhe "Skenderbeu"(Apologji)ne Venedik me 1636.





- Fjalori I Bardhit është fjalori I pare ne shqip qe permban afro 5 mije fjale.
- Ne kolonen latinisht jep kuptimin ne italisht, kurse ne kolonen shqip ai jep kuptimin ne turqisht .
- Fjalori permban dhe nje shtojcë, e cila është e ndare ne shtate krere: 1. Emra dhe Numerore, 2. Tituj familjare, 3. Qytete dhe kështjella, 4. Ndajfolje, 5. Parafjale, 6. Pashirrima, 7. Proverba, Fjalete urta, Dialoge dhe Pershendetje.

PJETER BOGDANI

- Pjeter Bogdani (1630-1689) është shkrimtari I fundit dh me originali ne letersine e hershme te shqiptareve , ndersa vepra e tij "Ceta e profeteve" është vepra e pare e rendesishme ne proze e shkruar drejtpersedrejti ne gjuhen shqipe.
- Lindi me 1630 ne Gur te Hasit te Prizrenit .Ai punoi per vepren mbi 10 vjet(1675-1685).



- Kryevepren e vet "Cuneus Prophetarum", Bogdani e botoi ne Padova(Itali)me 1685 me ndihmen e nje mikut te vjeter, kardinalit Barbarigo, te cilit I kushtohet kjo vepër.
- Kjo vepër ka dy velleme :vëllimi 1 është "Ceta e Profeteve" dhe vëllimi 2 është "De vita Jesu Christi, Salvatoris Mundi"(Mbi jeten e Jezu Kr ishtit,shpetimtarit te botes).
- Poezia e Bogdanit mund t klasifikohet ne:
 - poezi te krijimit,
 - poezi sibiliane,
 - poezi te kushtimit.

Epi i Gilgameshit

Epi i Gilgameshit është vlerësuar nga studiuesit sikur vepra më e vjetër e letërsisë, e njohur deri më sot.


Ky ep mbijetoi me shekuj, sepse u shkrua në dymbëdhjetë pllaka argjili. Shkrimi me të cilin u shkrua quhet kuneiform, që mendohet të jetë shpikur 3000 vjet p.K. në Mesopotami. Ky ep i mbijetoi kohës sepse u shkruanë shumë kopje. Dhe epi ishte në gjuhën Sumere.

Historia e Gilgameshit u ruajt në versionin akadian të shek. VII p.K., në bibliotekën e pasur të mbretit Asurbanipal. Më vonë Gilgameshi u tret ,derisa u rizbulua në mesin e shek. XIX të erës sonë dhe u përkthye në Gjermanisht në fillim të shek. XX.

Tek Epi i Gilgameshit rrëfhet jeta e Gilgameshit, mbretit të vjetër të Urukut, i cili ishte bir i hyjneshës Ninsun dhe i një babai vdektar. Gilgameshi ishte gjysmë-perëndi dhe gjysmë-njeri. Ai ishte ndërtues i murit të Urukut, dhe mendohet të ketë ekzistuar vërtetë. Pasi emri i tij njihet në listën e mbretërve sumerianë.




Tek Epi i
Gilgameshit
ekzistojnë tri
botë:





Gilgameshi është hero epik.



1

Pikëllimi i Gilgameshit fillimisht është një pikëllim njerëzor; ai vajton mikun e vdekur; zemra e tij plagoset.

2

Ai kupton se ka dashur mikun e tij, por gjithashtu është vdekja që e shkatërron.

3

Gjasht netë e ditë e qan Enkidujin, kurse ditën e shtatë e varros.

Fantastikja është e pamundshmja që bëhet e mundshme, lidhet me figurat letrare heroike. Heronjë të janë ata që ndërmarrin veprime të guximshme dhe kërkojnë zgjidhje të jashtëzakonshme, përballen me fuqitë më mëdha natyrore e mbinatyrore, njerëzore dhe mitologjike, hyjnore e gjysmëhyjnore.

Vetë natyra e letërsisë, e nënkupton së brendshmi fantastiken, lojën imagjinare me ngjarjet, njerëzit, hapësirën, kohën, etj.

Diskursi Fantastik

Gilgameshi dhe Enkiduji



Vdekja e
Enkidujit

Letërsia Klasike Greke

Kultura perëndimore, në shumë pika, ka për themel kulturën klasike greke.

Zhanret retorike, disa nga zhanret letrare, historiografia, filozofia etj,

Jeta e Grekeve ishte e organizuar dhe zhvillohej për brenda poliseve.

Dimensioni sociokulturor la gjurmën e vet në lindjen e formave kulturore e letrare.

Letërsia klasike në fillime dhe në kulmin e zhvillimit, I ruajti lidhjet me mitologjinë dhe me kulturën gojore përgjithësisht.

Me ndërrimin e modelit sociokulturor, shkrimi fillon e afrohet me diskurset Dokumentuese, me qëllim që të zhvillohet si shkrim i pavarur.



Periudha klasike

Shtrihet nga Homeri deri në shek.IV p.K.

Kur thuhet letër si klasike, për pos kushtëzimit kohor, nënkuptohet dhe modeli i saj.


Shtrihet nga fundi ishek.IV deri në shek.VI.

Gjatë periudhës helenistike, qendër kulturore u bë Aleksandria; qytet në Egjipt.

Ky vend u bë i njohur për bibliotekën e pasur që pati, si dhe për shkollën filologjike.





Periudha Helenistike







Retorika është të folurit bukur



Mësova nga Arnold Von Harfi

Mësova për të mësuar nga një njëri që nuk ishte vetëm një kalorës gjerman ,por edhe një udhëtar e shkrimtar. Ai gjatë udhëtimeve të tij nuk ishte vetëm një vëzhgues i prehtë ,por ishte edhe i interesuar në fjalët e të tjerëve se në çfarë gjuhe flasin. Për nevojat e veta ai shënoi disa fjalë shqipe që janë ca nga të dhënat më të hershme të gjuhës shqipe .

Mësova për të mësuar nga një shembull shumë i mirë për ne të rinjtë sepse na tregon që duhet të jemi kureshtar dhe të gatshëm për të zbuluar të panjohurën.

Era Desku



SEKRETI I SUKSESIT TIM

Përsosmëria është arti që fitohet nga stërvitja dhe përpunimi i zakoneve, pra nuk është një veprim, por një zakon. Asnjë nuk mund t'ju fyej apo t'ju lëndojë pa lejen tuaj, një nga çelësat e artë drejt lumturisë dhe suksesit është mënyra sesi i interpretoni ngjarjet që ndodhin para jush. Ndoshta do të kalojë një kohë e gjatë për ta kuptuar por pas shumë zhgënjimesh dhe asaj hijeje te zezë që të ka dalë para dhe nuk po të lë të shikosh asgjë tjetër. Erdhi momenti që t'i mbledhësh forcat e tua dhe ti dalësh zot vetes, ndalo së thëni vet se nuk je aq e mirë sa duhet, ti je perfektë ashtu siç je dhe nuk ke nevojë të ndryshosh asgjë, kujtoje gjithmonë se ti je e veçante dhe kurrë mos e ulë vetën për ta ngritur dikë tjetër sepse nuk ia vlen, ndjenjat e tua, shpirti yt ka më shumë vlerë se çdo gjë tjetër. Prandaj mos e gjyko vetën për at që je, por fillo të bësh më të mirën tënde. Asnjë herë mos shiko mbrapa sepse e djeshmja është e shkuara, ndërsa e nesërmja është e ardhmja jote, prandaj lufto për të se do të kuptosh për vlerat e tua.

Aulona Dalipi

Del i miri prej të keqit e i keqi prej të mirit

Jeta ka ngritje e zbritje. Takon njerëz të ndryshëm me eksperiencë të ndryshme dhe mësojmë prej tyre. Bëhuni shokë, kaloni moment të mira, plot gëzime, të qeshura dhe mendoni që ai është njeriu më i mirë në botë, që do ta keni pranë në çdo moment të dhe do të ndani çdo gjë me të. Pastaj, vij në moment të vështira, plot me të qara e tradhti, dhe atëherë, në momentet që ke nevojë për dike, nuk e ke askënd

Je i vetëm në këtë botë dhe mbetesh vetëm duke kujtuar momentet e jetës. Mundohu që fundi i momenteve të kujtuara të sjellë lumturi me veprimet e tua për gjatë rrugëtimit që ke bërë.

Ardit Ymeri

Eci nëpër shekuj

Të gjitha shkrimet e tanishme kanë një karakter mbyllës të cilat gjinden jashtë gjuhës së folur . Shkrimi nuk është aspak një mjet komunikimi , ai nuk është një kanal i hapur përmes të cilit kalojnë vetëm qëllime gjuhësore . Një çrregullim rrjedhë përmes fjalës dhe i jep lëvizje gllabëritëse që mban gjendjen e pezullimit të përjetshëm. Në të kundërtën , të shkruarit është një gjuhë e materializuar që jeton në veten e tij dhe nuk ka aspak detyrën t'ia besojë kohëzgjatjen e vet një vazhdimësie të lëvizshme të përafërt.

Që nga ditët e parahistorisë gjuha ka kaluar një rrugë të gjatë paralelisht me njerëzimin . Ngjarjet që ne i njohim (falë historisë) janë ruajtur me anë të gjuhës.

Ndonjëherë ndalem dhe mendoj se cila mënyrë e jetës ishte më e mire, ajo në kohën e Kanunit të Lek Dukagjinit, apo sot. Në kohën e Kanunit respektoheshin ligjet dhe rregullat e jetës, ndërsa sot, jo vetëm që koha ka ndryshuar, por ato ligje më nuk respektohen, janë harruar. Në atë kohë të gjithë kishin respekt për njëri-tjetrin. Vendin e mikut nuk ka mund ta zënë askush . Shoqëria ishte e vërtetë, nuk kishte mashtrim . Kur po eci neper shekuj duke lexuar ,po me duket se miqësia kishte vlera me shumë Sot ,ditët po ecin ,vitet po shkojnë ,mua me duket se jeta është kthyer ne interes shkatërrues.

Mirëmëngjesi interes! Për nga muzikaliteti ,mirë tingëllon ,-siç duket kjo po i mashtron njerëzit .

Çdo gjë që shndritë nuk është ari . Njerëz, ecni me kohën , mos vraponi pas muzikës ,se edhe ajo mund t'ju deh ,e humbni rrugën e një jete harmonizuese me vrapin që e bëni. Kam mësuar se po e shkele njërin nga rregullat e Kanunit je ndëshkuar,udhëheqësit e fshatit mblidheshin dhe i jepnin dënim atij personi. Sot ,unë mësoj nga te tjerët .

Mëso nga gabimet!

Por,gabimet janë aq të pa falshme sot saqë nuk të mësojnë,por të ngarkojnë.Eci nëpër periudha historike ,e gjejë një forcë njerëzore të personalitet e ndryshme njerëzore .Te arriturat e tyre me japin motiv për të ecë nëpër vite pa frikë e pa trishtim .

Sot ,ndonjëherë shqetësohem nga mos respektimi i njeriut për njeriun. Njeriu dhe natyra e tij duhet respektuar ashtu si është,janë fjalët e një njeriu që me edukon dhe me përgatitë për jetë.

Po eci neper vite ,po mësoj nga e kaluara,po ndërtoj tipare pozitive nga fjalët e njerëzve të pa vdekshëm , fjalët e tyre me japin gjallëri,po edukohem nga njerëzit me vlera .

Prej atyre gabimeve njerëzit mësonin dhe nuk i përsërisnin më. Por çfarë kuptimi kanë sot ato ? Njerëzit bëjnë gabime dhe prapë se prapë nuk marrin mësim prej tyre dhe vazhdojnë ti përsërisin . Pastaj më vonë kur ata të pendohen është e kotë .Koha ka shkuar dhe nuk kthehet më

Artisti nuk është mbyllur në një mjet të vetëm për të krijuar art me shkronja, po harmonizon edhe art me vepra. Fjalët na mësojnë ,veprat na edukojnë I mësuarin dinë të mësoj ,i edukuarin dinë të edukoj !

Respekt për njerëzit që dinë të edukojnë brezat e rinj .

Barbara Beqiri

Dashuria

Ka qenë një vajzë e magjepsur pas djalit që dashuronte. Sytë e saj të dëshpëruar skuqeshin fshehurazi ajo shkruante letrat e saj për dashurinë .Kishte diçka që ajo donte të thoshte. Por nga kush kishte frikë? Dhe kur do që të takoheshin ajo do ta pyeste ...Si ndodh dashuria? Si ndodh dashuria ?Gjithçka që ai mund t'i thoshte asaj ishte...

Në se sytë e tu janë të hapur ose të mbyllur. T'i gjithnjë do të ëndërrosh për atë që do. Për ty gjithnjë ka vend urrejtja...Zemrën do ta kesh gjithnjë plot me dashuri. Edhe nëse dashuria ka për të vdekur. Edhe nëse dashuria ka për t'u zhdukur,dashuria jeton përgjithmonë.

Unë dëgjoja me vëmendje fjalët ,ndërsa muzika më qetësonte.

Dashuria...Frymëzim i madh për muzikën. Dashuria dhe muzika janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën. Të dyja e kanë origjinën nga zemra... dhe fatet e të dyjave varen nëse zemra e shpreh atë. Nëse t'i do dike thjesht shko dhe thuaja. Mos u shqetëso nëse refuzon ose pranon. Në mënyrë të ngjashme, nëse s'vihen ne ndjenja sikur jeni duke luajtur me një instrument që keni para syve...Thjesht merre një mësim për një hap me tej për menaxhimin e ndjenjave tua , mos u shqetëso .Vetëm dëgjoni zemrën tuaj dhe bëni çfarë ju thotë ajo. Aq shumë urrejtje ka në këtë botë. Megjithatë zemrat janë të mbushura me dashuri. Dashuria është e njëjtë si jeta, nuk është e lehtë ta duash dikë , dhe nuk të sjell gjithmonë lumturi...Por kur ne nuk ndalojmë së jetuari, pse duhet të ndalojmë së dashuruari.

Dikush duhet të dojë kështu si je , jo në mënyrën që ai do që t'i të jesh... Nëse dikush do të të ndryshojë ty, atëherë nuk është dashuri por kompromis, dhe askush nuk bën kompromis në dashuri. Ndonjëherë kur kemi qeshur dhe kemi qarë për gjëra të vogla, të kam dashur. Ndonjëherë kur kemi kërcyer në shi , të kam dashur. Kur kemi qëndruar jashtë duke numëruar yjet , të kam dashur. Tani ,kam harruar se sa kohë ka,që të kam dashur. Unë mundem thjesht të them se të kam dashur ty dhe vetëm ty.

Dashuri nuk do të thotë vetëm të thuash "të dua".Dashuria është e tillë edhe kur nuk thua asgjë. Dashuria është sakrificë, do të thotë, mos të thuash asgjë për hir të njëri-tjetrit. Dashuria nuk është posedim. Dashuria është të heqësh dorën nga lumturia jote për lumturin e dikujt tjetër.

Dashuri do të thotë sapo ta takosh personin që ta sundon zemrën . Dashuria është një ndjenjë hyjnore shumë e fuqishme të cilën dhe po të duam nuk e mposhtim dot. Ajo është e ëmbël si mjalti, na ndriçon shpirtin si rrezet e arta të diellit dhe na jep shpresë e forcë për të takuar çdo pengesë. Dashurinë, respektin, sekretin po edhe hidhërimin, problemin nuk do duhet t'i përjetosh vetëm por me njerëzit e zemrës .

Problemet do të duken të vogla në krahasim me forcën e dashurisë tuaj. Që të jesh i dashuruar do të thotë që vetëm një shikim ose buzëqeshje e njeriut që do, të bën ta shumëzosh botën me zero .Megjithëse dashuria është kaq e madhe ,ajo ndonjëherë mund të jetë fatkeqësi për ne. Sidomos kur ajo është e njëanshme. Ne mundohemi t'i sillemi vërdallë dikujt por ndodh që asnjëherë mos ti afrohemi. Ashtu si Hëna që i sillet rreth Tokës ,por asnjëherë nuk e arrin . Ne nuk duhet të dorëzohemi deri sa të gjejmë atë dashuri, që do t'ia dhuroj çdo ditë me gëzim e lumturi . Atë dashuri që do na bëj të jetojmë çdo ditë sikur të ishte e fundit. Dashuria është miqësi, pa miqësi nuk ka dashuri. Dashuria është jetë. Ti vetëm duhet ta gjesh. Dy njerëz janë për njëri-tjetrin. Si zemra dhe rrahjet e saj .Si syri dhe qerpiku. Janë bërë për njëri-tjetrin. Zemra është e çmendur. Zemra është e trullësuar. Sjell pagjumësi .Vjedh gjumin dhe rehatinë. I tregon atyre rrugën e dashurisë. Sjell gëzim dhe lot. Aq afër sa këngët janë me buzët. Aq afër ëndrrat janë me sytë. Jep jetë për atë që të fal dashuri .Dikush! Është duke pritur ...

Barbara Beqiri

Eh sikur të ishte e mundur

Eh sikur të ishte e mundur ,të jetonim në një botë paqësore ,ku armët e drogat të ishin lapsa e fletoreçdo ditë po vriten me mijëra të rritur e fëmijë, çdo ditë një jetë e ndritur po shuhet ,një e ardhme ,si do të ekzistojë ??? Po ,a është e menduar ndonjëherë ?-Se ajo jetë që tani nuk ekziston ,mund të ishte jeta që do të na shpëtonte të gjithëve ?! Po të ishte një person që do të bënte një kur për një sëmundje ,të ishte një arkitekt ,që do ta zbukuronte këtë botë ,apo të jesh edhe një punëtorë i thjeshtë por që do të ndihmonte në zhvillimin e kësaj bote .Gjersa ti e mendo këtë ,ja ku vdiq edhe një ,por kjo s'po ndalet .e nuk do të ndaletEh sikur të ishte e mundur ,por jo që nuk është, kjo botë është e përgjakur ,dhe kurrë s'do të pastrohet më.....

Ardit Ymeri

Eh,sikur të ishte e mundur

Imagjinata ime më dërgon në vende të ndryshme dhe shoh bukuri të rralla .Vizitoj piramidat e lashta ,ujëvarat e mrekullueshme ,pyjet e pasura .Imagjinoj sikur jam duke fluturuar dhe shkoj lart në qiell mbi retë e buta .Shoh perëndimin e diellit dhe fluturoj mbi ylber .Fluturoj krah me aeroplanët dhe tufë të zogjve .Ndërsa imagjinata ime më dërgon nëpër këto vende ,unë kthehem në realitet dhe e gjej vetën ulur para hartës ,me një cope letër përpara duke shkruar për ëndrrat e mija .
Eh,sikur të ishte e mundur do të fluturoja .

Dea Buleshkaj

Sikur lutja ime të hidhej në pentagram do të dilte një simfoni e bukur

Dëshirat e jetës na bëjnë të lutemi për to, e këto lutje krijojnë një simfoni, përkushtimi mbi pentagram. Notat më të bukura përshkruajnë vullnetin tonë për të arritur ato që dëshirojmë, kështu krijohet melodi sfidash, këngë me vargje jo gjithmonë të lumtura. Shpesh fjalët që shkruhen në tekstin e këngës së jetës tonë, na japin bindjen që s'mund t'ia dalim, mirëpo a duhet t'i humbim ëndrrat për një pengesë?

Lutja është pjesë e mëshirës së fatit. Edhe unë lutem... Lutjet e mija janë bërë vargje brenda zemrës që pret shumë nga kjo botë, por sikur akoma i mungon kompozimi, që besoj do ma falë koha. Mendimi pozitiv, ose thjeshtë qëndrimi im i fortë përballë së keqes më ka falë durimin, e unë sot lutem që brenda meje të krijohet besimi që shpesh më mungon. Kështu valët e jetës s'do përplaseshin furishëm mbi karakterin tim. Lutja humb fuqinë e së keqes, është si shtyllë ku mbështesim shpresat. Prandaj, "të lutem", a s'është kjo si refren i këngës së jetës së secilit nga ne!

-Erisa Berisha

Gjinden shumë duar njerëzish

Çdo gjë filloj nën rrjedhën e një jete normale ,tek një familje e ndershme, bujare e me zemër të madhe .Jetonin në një shtëpi të punuar me copëza guri, u përkushtuan me dashuri duke ëndërruar që së bashku ti risin pasardhësit e tyre Një ditë mëngjesi nën zhurmat e armëve të trishtuara të armikut ,jeta e njerëzve ishte prangosur dhe në çdo familje mbizotëronte një aromë robërie. Ishte momenti kur shqiptarët kishin nevojë për njëri tjetrin ,ngase ishin shumë krenar të dorëzoheshin para armikut për një copë bukë e një gotë ujë ,që në ato momente ishin shpëtim jete. Bujaria e një familje që jetonin në një kasollë e hapi derën për strehim . Bujaria ,trimëria dhe mençuria le të jenë motiv për ne të rinjtë që mos ti harrojmë traditat shqiptare.

Afeida Neziri

Letër personale

Prishtinë,15 mars 2013

I dashur,

Dua të më flasësh të më zgjosh nga gjumi.Mbase s'të interesoj më ose mbase nuk më beson më ,sepse asnjëherë nuk më ke besuar ,unë gjithmonë të kam dashur .

E di që diku thellë në zemrën tënde ke ruajtur një vend për mua .Brengosem se a do të shoh ndonjëherë brengosem.....

Sa here që kaloj afer teje ,kthej kokën me një anë ,me mendim sikur jam duke shikuar natyren ,e jo ty. Në ato caste kur ti flet unë mundohem të mos vë vesh fjalët e tua ,jo pse dua por pse tip o ma imponon .

Ti nuk mundesh kurrë të më uurresh mua sepse engjujt nuk urrejnë njëri – tjetrin ,prandaj do t ishte e kotë të më urreje ,se urrejtja jote do të kthehet dikur në dashuri e dashuria jote në mbrojtje për mua ,Je pjesa më e bukur e jetës time ,ndërsa unë ,përsonezhi më I dashur në librin tend.

Aulona Dalipi

I përkas këtij brezi

I përkas një brezi të cilit i kanë mësuar se shkolla e parë shqipe u çel në Korçë, më 7 mars të vitit 1887, si pjesë e përp

Sa i takon shumicës myslimane të shqiptarëve, kjo zakonisht likuidohet, nga historiografia nacionaliste, si “analfabete”, me gjithë faktin e njohur që, në disa qytete – si Shkodra, Prizreni, Elbasani, Berati – ekzistonte një shtresë e mesme shqiptare, me interesa kulturore të spikatura (siç e dëshmojnë, ndër të tjera, arkitektura, artizanati, interierët e shtëpive të banimit, kuzhina dhe, të mos harrojmë, letërsia e bejtexhinjve).

Vizioni historiografik zyrtar, sado i lëkundur sot, mbetet teleologjik; historia si lëvizje në përmasën kohore, e tillë që e shkuara të përgatitë të ardhmen dhe e sotmja të paraqitet si rezultat i së shkuarës. Sipas këtij vizioni, bie fjala, marrëdhënia midis përpjekjeve të Skënderbeut kundër osmanëve në shekullin XV dhe statujës së Skënderbeut në sheshin kryesor sot në Tiranë nuk është thjesht simbolike. Gjithnjë sipas këtij vizioni, historia e arsimit shqip duhet të përshkruajë rrënjët e institucioneve të sotme arsimore – dhe nga kjo pikëpamje, 7 marsi mbetet datë korrekte.

Natyrisht, ky s’është i vetmi vizion i mundshëm. Ideja se, së paku gjatë periudhës osmane, arsimi në trojet shqiptare e ka përdorur shqipen si mjet ndihmës, ose për komunikimin mes mësuesve dhe nxënësve meriton vëmendje të madhe. Për shembull, [Voskopoja](#), gjatë shekullit XVIII kishte një shtypshkronjë, ku u shtypën ndër të tjera edhe libra shqip, kryesisht me shqipen të vënë krah për krah me gjuhë të tjera të Akademisë. Ndërkohë, shumë nxënës të Akademisë, si Theodhor Haxhifilipi (Dhaskal Todhri), Kostë Ikonimi, Evstrat Vithkuqari u kthyen pastaj të punojnë si mësues në viset e tyre. Lidhja e kësaj lëvizjeje, sado embrionale, me Rilindjen nuk mund të shpërfilllet.

Nga ana tjetër, tradita e shkollave katolike shqip në Veri të Shqipërisë vazhdoi, sado e ndërmjetësuar, me autorët dhe personalitetet gege katolike të Rilindjes Kombëtare. Në këtë mes, primati i datave ka më pak rëndësi dhe ngre më pak peshë sesa qëmtimi i gjurmëve të vijueshmërisë.

Kritikët e historiografisë zyrtare të arsimit shqip kanë të drejtë, të paktën në një pikë: 7 marsi nuk duhet marrë kurrësi si datë e fillimit të arsimit shqip – meqë nuk është e tillë. Është vetëm datëlindja e arsimit shqip ashtu siç e kemi sot. Përndryshe, nga hulumtimi i traditës së shkollave të huaja, në trojet shqiptare, do të vijë me siguri shumë të dhëna të reja, edhe për historinë e arsimit shqip.

Barbara Beqiri

Lisi i mire njihet nga fryti

Çdo njëri mund të konsiderohet si një lis ,e të bëmat janë fryti i këtij lisi
.Mënyra se sillemi ne me të tjerët ,tregon frytin e ndërtuar në familjet tona .

Ardora Bilibani

Krenari ,të lutem a mund të më marrësh me vete?
Barbara Beqiri

Ma mirë është për të heshtur se me fol shumë.
E falënderoj Frang Bardhin për frymëzimin që ma dhuroj me këtë thënie.
Përgjegjësia dhe detyrimet janë dy anët e medaljes .Po i respektojmë të dyja
ndërtojmë moral që i mbron traditat e familjes. Dëgjo ,mendo ,hulumto ,krijo e
mos fol atë që s'të përket ty,mos e fol atë që e lëndon tjetrin e vetën tënde .

Dion Dermaku

Ma mirë hesht se me fol

Unë vi këtu veç kur ti nuk je më ! Kur këtij qyteti i shlyhet grafiti i bërë prej
teje .Shenjat e këmbëve të tua ,që gjithmonë shpirti im ka dashtë me i ndjekë.
Nuk mundem më

Shoh fëmijët në park duke u dehur në ëndrrat e tyre e i mungojnë duart e tua.
"Më mirë me hesht se me fol" Kur fjala krijon problem më mirë largohu në
heshtje .Ndonjëherë heshtja është flori .E tani unë po heshti se me mullinjtë e
erës nuk mund të luftoj . Tani unë vi këtu vetëm kur ti nuk je ,për t'ju shpëtuar
fjalëve të tepërta dhe heshtjes e cila prej që je largu mi kujton netët e ftohta
me shi.

Unë vi këtu ,kur mungesa jote bën që fjalët të humbin peshën e ndjenjës sa
po prekin në letër .Një ëndërr që nuk mbaron ,një shekull!

Gresa Isufi

Miti i veshjes

Në ditët e sotme me apo pa dijen tonë veshja ka një rol shumë me te rëndësishëm në gjykimet dhe përcaktimet tona për një person tjetër, dhe sigurisht që edhe të tjerët së pari neve nga veshja na gjykojnë. Dhe ndoshta kjo do të thotë se jetojmë në një botë ku gati çdo person përbëhet nga paragjykimi për të tjerët dhe nuk nguroj ta pranoj që edhe unë ndonjëherë bëj këto paragjykime...Në një mënyrë kjo është normale se tani një adoleshente vishet dhe rregullohet si një grua e rritur, apo një grua e rritur vishet në një mënyrë provuese dhe pastaj përballet me një rreth të ngacmimeve, fjalëve dhe shikimeve të njerëzve të ndryshëm, persona të cilët i shprehin mendimet e tyre, mirëpo më së shumti kjo veshje ndikon mendimet e njerëzve dhe sjelljen e atyre njerëzve me atë person, mirëpo do t'i vlerësoja edhe ato veshje dhe ata persona, sepse ata kishin një guxim ta shprehnin vetën pa i dëgjuar mendimet e të tjerëve. Këtu lind pyetja, - Pse jemi bërë kaq të etur për veshje të modës së fundit? Një përgjigje e këtillë është më e komplikuar saqë duket!

Së pari duhet të ceket se presioni bie nga njëra anë nga media, duke filluar nga profilet e njerëzve të famshëm e deri te reklamat televizive. Ndoshta duket e çuditshme, por këto media me marketingun e tyre profesional na bëjnë presion mjaft të madh. Pastaj, këtu bën pjesë edhe konkurrenca, secili nga ne dëshirojmë të dukemi sa më bukur, dhe kur të tjerët kontribuojnë më shumë në dukjen e tyre a po veshjen e tyre, ne ndihemi xheloz dhe kemi dëshirë të konkurrojmë me ta. Dhe si për fundi pyes se: A vishemi ne sipas karakterit tonë, apo vishemi vetëm duke krijuar mit veshje ? Dhe, e udhës është që të vishemi më shumë për veten, se sa për të tjerët, duke pasur kështu dhe një qetësi dhe një rehati të mirë shpirtërore.

Afeida Neziri

Nderi

Gjergj Elez Alia është një shembull për të gjithë ne shqiptarët .Edhe pse personazh mitik në një histori të trilluar. Gjergj Elez Alia tregon një personazh me tiparet më të mira njerëzore ,tregon guximin ,trimërinë ,nderin e dashurinë që duhet ta posedon secili shqiptar.

Ai i plagosur me nëntë plagë në momentin kur erdhi koha ta mbrojë moralin e familjes ,harrojë vetën ,mori shpatën për të mbrojtur nderin e familjes .Më rëndë peshonte nderi i familjes se dhimbjet në trupin e tij . Rehatia dhe qetësia e një njeriu human prishet kur është në pyetje nderi. Ne ,populli shqiptar kemi mjaftë shembuj për tu mësuar ne gjeneratat e reja për tiparet më të mira njerëzore ,Gjergj Elez Alia ,një personazh për shembull të mirë për kundër të bëmave ,karakterit i tij na mëson shumë gjëra të nevojshme për tu zbatuar në jetë.

Ndonjëherë edhe neve mund të na prishet rehatia jonë shpirtërore e fizike, por ajo kurrë nuk do të duhej të merret si problem ,sepse të gjitha të bëmat që unë mund ti bëj janë ajo që po i duhen kësaj bote njerëzore .

Ardora Bilibani

Model i fjalës dhe i veprës

Përfshirja e një pjese të mirë të territorit shqiptar nën sundimin osman, krijoi një pështjellim të madh në mjedisin shoqëror të kohës. Ankthi, pasiguria dhe mëdyshjet, përzier me ndjenjën e revoltës dhe të kryengritjes, ishin tiparet

Në ëndërr

Kalova shumë kohë këtu ,ndihem e lodhur ,e rraskapitur nga njerëzit të cilët thonë gënjeshtër .Mjaftë më ,sikur durova gjatë ,shpresova me gjithë forcën se diçka do të ndryshonte ,por nuk ndodhi. Dhe sot e gjej vetën para një të vërtete që s'do të ndryshoj deri sa unë nuk bëj diçka për ta ndryshuar dhe sot, zgjedh të jem e lumtur,sepse kaq shumë luftova për lumturinë e të tjerëve ,tani do të luftoj për lumturinë time.....E humba vetën nën tingujt e mijëra zërave të heshtur që kumbonin në mendjen time dhe sikur zemra më rrihte shpejtë .Tani të shkelja tokën kisha frikë se jeta ime do të kthehej në bardh e zi .

Po këtu unë vlejë diçka ,jam më tepër se një zë i mbytur . Kohën nuk e ndalova në këtë vend por ajo vazhdoi deri atëherë kur magjia përfundoi dhe realiteti im i trishtuar më ishte falur si një dhuratë që nuk e doja ,por duhet ta pranoja .Afeida Neziri

Në zemrën time kam një ndjenjë

Jeta ... Një fjale e cila përmban kaq ndjenja por mbizotëron egoizmi. Egoizëm, si mund ta përkufizojmë me një term këtë fjale e cila përmban shumë. Por të tillë mund ta quajmë kohën e cila kalon pa prituri askënd e duke menduar vetëm për veten e saj, pra, koha është vet jeta.

Kur flasim për dashuri asnjëra nga ne nuk dimë se si ta përkufizojmë këtë nocion , mbase asnjëra nga ne nuk është ndjerë ndonjëherë e dashuruar . Ndjenjë kjo që po e çmend gjithë botën? As unë nuk e kam përjetuar asnjëherë,por si do te ndjehem kur të bie në dashuri ? A do dashurohem në shikim të parë? Do të hyjë një shigjetë në zemrën time , do e shpoj atë tej përtej ,në dy pjesë, njëra do jetojë për të dhe tjetra për mua, në zemrën time do të ketë një ndjenjë Kështu më kanë thënë..

Emocione kur je afër tij, shkëlqim syve e frymëmarrje të shpeshtuar. A do më mbuloj turpi kur ti flas? Jo, do të buzëqesh ëmbël. A do më tërheq më shumë pamja e tij apo shpirti ?Do të jetë i qet apo i zhurmshëm. A do o mund të sakrifikoj,për dashurin e tij? Do të jemi afër si qielli dhe retë,apo larg si yjet dhe toka. Do ta ndiej atë në sytë e mi. Do e ndiej atë në rrahjet e zemrës sime. Do të kem ndryshime në diskursin tim. Çfarë do të bëjë zemra ime e çmendur,as vet nuk e dijë...

Do e shoh tek të gjithë fytyrën e tij. Do të këndoj këngë për të. Dashuria e tij do të më ndryshoj jetën time . Do të shfaqet ai në ëndrrat e mia. Unë do të jetoj vetëm për të,sepse ai do te jeta ime .Sa do të rri duke prituri atë,prapë nuk e dijë.

Do të jetë ai jeta ime.

Lumturia e dhimbja janë pjese e kohës që kalojnë, por a do të kishte lumturi po të mos rrinte përkrah saj dhe dhimbja, por a do ekzistonte jeta po të mos ishin këto ndjenja?! Përgjigjen do e kërkonim ne zemrat tona e zemra do të na thoshte... Jo nuk do të ekzistonte ,sepse çastet e dhimbshme te bëjnë te kuptosh vlerën e lumturisë e nëse e kupton vlerën e lumturisë do të përqafoje jetën e do të pajtoheshe me kohën.

"Koha është flori" "Jeta është thesar " e "Dashuria melodi" e kemi për detyrë ti ruajmë ,ti vlerësojmë e ti duam. Shih përsëri rrotull tani, bisedo me kohën e jeta përsëri do te të përqafojë, dashuria do të lumturoj.

Barbara Beqiri

Shpirt për shpirt se duken e fal Zoti

Paragjykimetkanë qenë ,janë ,dhe do të jenë gjithmonë pjesë e shoqërisë ato krijohen në momentin e takimit të dy apo më tepër personave ...qofshin ato të mira apo të këqija ,të sakta apo jo.

Paragjykimi është një akt I neveritshëm ,por që fatkeqësisht nuk mund të shmanget , A është domosdoshmëri të akuzohet një Indian I pa shkolluar apo një njeri që I takon races të zezë të themi se është njeri I rezikshëm .Në këtë botë ekzistojnë paragjykimet dhe trajtimet e pabarabarta .

Ne ,njerëzit ,të gjithë kemi të meta ,dhe të gjithë I përkasim një shoqërie ,por pse vallë duhet trajtuar tjetrin ndryshe ? E gjithë kjo duhet të ndalet ,për njeriun dhe ndjenjën shpirtërore të tij ,se duken e falë Zoti e shpirtin e ruan vetë Njeriu .

Të këqijat të mësojnë

Nuk ka njeri perfekt.....

Neve na është krijuar mendja ,por nganjëherë ajo reflekton me vonesë .Çdo e keqe sjell një mësim,e çdo mësim na bën më të vetëdijshëm për një të ardhme më të ndritur.

Të këqijat mësojnë

Sa herë që njeriu rrëzohet bëhet edhe më i fortë .Kam dëgjuar se është rregull i jetës sidomos për njerëzit që mësojnë nga gabimet e veta .Unë do të them :,,Mëso nga gabimet e tjetrit që mos të gabosh vetë,mëso edhe nga gabimet e tua ,që mos t'i përsëritësh më!"

Erisa Berisha

Të falësh

Çdo hap,çdo gabim ,çdo falje ka një pikë ndjenje. Ndjenja që tejkalon kufirin e gjërave të lejuara ,që sakrifikohen në mënyra të ndryshme atëherë humbja dhe kthimi i një personi janë të barabarta .

Kush është i paaftë të falë ,është i paaftë edhe të dojë! Të falësh ,nuk do të thotë të lesh në hije atë ka ndodhur ,ajo vetëm duhet të krijoj atmosferën pozitive për një fillim të ri .Shkalla e faljes për të cilën jemi të gatshëm ta bëjmë përcakton shkallën e dashurisë ,atëherë themi se forca dhe ndershmëria e njeriut shprehet me vullnet të mirë .

Çelësi kryesor i paqes njerëzore është mirëkuptimi në mes të njerëzve .

Leona Rexhepi

Të Dashuruarit në fund fitojnë

Disa njerëz nuk besojnë në dashuri por, ndërtojnë mit. Disa të tjerë kanë një pasuri para vetes ,njeriun qe e ëndërron dhe disa te tjerë kanë frikë nga dashuria.

Çdo njeri ka shpirtin e tij binjak .

Ku je ? Po te kërkoj!

Nuk do të jetojë përgjithmonë. Kjo botë nuk do i mbesë askujt. Me kane thënë se Jeta është aventurë, që të gjithë do e kalojmë.

"Të dashuruarit në fund fitojnë",tani unë te besojë apo te mos besojë. Te të cilët njerëz te radhitem ? Pas çdo shiu lind diell ,pas çdo hidhërimi vije lumturia .

Do fitojnë sepse në fund do t'ia arrijnë qëllimit do të jenë bashkë dhe askush nuk mund ta ndal këtë. Sikur tek filmi "Të dashuruarit në fund fitojnë" ata të dy pas çdo vështirësie ,edhe pse vajza ishte e fejuar .Ai nuk u ndal ,shkoi ta merrte atë. Dhe në fund fituan. Të dashuruarit, dashuria ka shumë fjalë për ta shprehur këtë ndjenjë. Por vetëm të dashuruarit e din se si është. Ata që vërtet e duan njëri-tjetrin. Por pse disa prej njerëzve nuk e besojnë ? Çfarë ka të keqe që nuk e besojnë. Ndoshta nga që ata nuk janë ndjerë asnjëherë në këtë mënyrë. Pavarësisht nëse të dashuruarit janë larg me vite të tëra, dhe nuk e shohin njëri-tjetrin, ata prapë do të bëhen bashkë. Dashuria është gjithçka. Dashuria është e bukur. Është një fjalë "Mirëserdhe në botën e dashurisë .Eja më shih në sy. Zemra ime ka marrë flake. Të digjesh nga dashuria është lumturi. E nesërmja i përket një tjetre. Të hedhim hënën si një monedhë. Të shohim në ç'anë bie ,nga fytyra jote apo jeta ime." Dashuria është një lum I pandalshëm, lundron në dallgët e tij .Qëndron lehtë mbi re, këmbët tua nuk e gjejnë tokë .Zemra është pa kufi ,asnjë kufi nuk e ndan atë. Kur trupi yt ndalon së marri frymë dhe kur bashkohet me të dashurit tënd, mund të marrësh frymë. Aroma e trupit të tij ,prek shpirtin tënd. Kur të duket se e sheh çdo kund. Askush nuk mundet ta ndal dashurin e tyre. Ja përse çdo histori dashurie përfundon bukur. Por gjithmonë ka vuajtje .Kjo është ajo që e bën të bukur dhe të dhimbshme.

Themeli nuk luhatë

Nëse një shtëpi ka një themel të dobët ajo do të shembet lehtë. Por çfarë ndodh nëse personi ndërton themel të luhatshëm ,si shembet ajo?

Nga një stuhi kalimtare themeli I pa ndërtuar mire shembet

Kjo është një ndër mësimet e para që mora në këtë jetë .Në çfarë do aspekti sa më shumë që e reflektoj këtë pohim aq më shumë vetëdijesohem dhe njëkohësisht e pyes veten;Çfarë na bënë neve më të forte?

Çka na përcakton themelin ?Çfarë na bënë të rrimë në këmbë ?

E ironia e këtij titulli ishte që sa më shumë e mendoj ,aq më shumë më zgjon kureshtjen e fjalës „THEMEL" fjalë e cila përdoret në shumë aspekte ,por për mua është një fjalë e fuqishme me plotë vlera .

Për mua ajo shpreh një kapacitet të pamatur,kapacitet I cili çdo kush e kërkon e ndoshta askush nuk e posedon si pasojë e vetë natyrës njerëzore .

Afeida Neziri

Themeli nuk Zhgulet

Edukimi është themel për një jetë të shëndetshme.

Ne e dimë se themeli i popujve shqiptar është ndërtuar me shumë mençuri, me sakrificë e me shumë vuajtje. Rrënimin e themeleve tona ,nuk e kanë lejuar të parët tonë duke luftuar edhe pse shumë shqiptarë u detyruan të largohen nga vendi i tyre,por themelet e të parëve nuk i harruan.

Bleta ulet në çdo lule ,por nuk mbledhë mjalhtë kudo . Shqiptarët jetuan në çdo vend të botës ,por traditat nuk i ngatërruan ,e ruajtën mjalhtë e vendlindjes . Guri i rëndë peshon në vend të vet. Thonë të moshuarit se rruga e dijes është e shtruar në akuj ,në atë moment që ndalesh do të rrëzohesh . Shumë popuj u munduan të na ndalojnë mu në mes të akullit ,por nuk arritën . Ne vazhduam të ndërtojmë përmes një rruge të gjatë ,të lodhshme,e me shumë vuajtje. Sfidat na u paguan se Themeli mbet Themel Shqiptar .

Aulona Dalipi

Vetmia,kthim ne vetvete.

Unë vetminë e perceptoj si metamorfozë të gjendjes emocionale. Ne shpirt mbizotëron një qetësi e ndikuar nga faktorët e jashtëm. Individit e tërheq veten drejt një guace ku mund të shohë me kthjellim çdo moment që ka kaluar. Sa fjalë e brishtë dhe e dhimbshme tingëllon kur e shqipton:"vetmi",ama kur e kupton,mbyll sytë dhe paqja sundon mbi çdo qelizë të trupit tonë. Një zë i brendshëm të pëshpërit dhe të thotë:Mos u trishto,jemi bashkë. Ah...kjo është vetvetja që të flet dhe të magjeps.

Një proverb e ndan vetminë në dy drejtime:te këndshme dhe të egër. Vetmia është e këndshme kur e zgjedhim vet,mirëpo ajo është e egër kur detyrohemi në të!Ndonjëherë e adhuroj momentin kur gjendem vetëm në shtëpi. Një frymëmarrje e thelle dhe...BUM! Shpërthej. Jam unë ajo që vëzhgon,kontrollon dhe sundon. Këndimet,kërcimet,hedhjet tani më nuk janë një problem. Kjo është vetëm njëra anë e medaljes së vetmisë. Ajo vetmi e shkaktuar prej zhgënjimeve të realitetit,te rendon,te peshon dhe nuk të le të marrësh frymë lirisht. Një vel palumturi të mbulon...Mbyllesh në vetvete sepse mendon se tani më nuk ndodhet asnjë aty për ty. Njerëzit të duken si copa akulli që nuk kuptojnë. Është si të them...një fletë e bardhë e mbushur plot me ngjyra . Ta përcaktoj vetminë nuk është e vështirë,por ta zgjedh atë është thujse e pamundur. Zgjidh ngjyrën më të bukur,zgjidh atë që të bënë të ndihesh e lumtur.

Barbara Beqiri

Homeri

Autorësia e poemave Iliada dhe Odisea i atribuohet Homerit. Të dhënat për Homerin janë të pakta. Homerë është përshkruar si një plak i verbër.

Ka edhe disa mendime që Homerë nuk ka ekzistuar, ndërsa emri Homer është i trilluar. Iliada dhe Odisea është shkruar qysh në antikitet.

Kërkimi i autorësisë, i kohës së krijimit të këtyre teksteve dhe i dallimeve ndërmjet tyre njihet si Çështje Homerike.

Epopeja është zhanri themelor i epikes klasike. Temat e saj janë të larta. Epopeja thurret rreth një personazhi kryesor, një heroj.

Në dallim nga tragjedia, heroj i epopesës është e thënë të jetë tragjik. Mjafton që ai të jetë i rëndësishëm. Epi klasik është shkruar në varg heroik.

Në epin, si për gjithë epikën, narratori është një nga kategoritë kryesore.

Iliada ka për temë Luftën e Trojes, kurse Odisea ka për temë kthimin e heroit (Odise) në shtëpi.

Iliada ka 24 këngë, në të cilat këndohet Lufta e Trojes. Iliada hapet me zemërimin e Akilit ndaj Agamemnonit.

Diskursi heroik është një shenjë identifikuese e epopesë. Diskursi heroik. Homerit's është larg diskursit fantastik.

Diskurset Poetike

Edhe pse shenjat e dromcat poetike hasen me herët, edhe brenda epikës,
Diskurset poetike klasike njohen zhvillimin e vet më të madh në shekullin
VII dhe VI para Krishtit.



Arkiloku ka jetuar në gjysmën e parë të shek. VII p.K. Nuk ka shumë të dhëna për të. U bë i njohur si autor i vargjeve jambike.

Alkeu thuhet se ka jetuar nga fundi i shek. VII dhe në fillimet e shek. VI.
Mendohet të ketë pasur së paku dhjetë libra.

Safo është poetja e parë e njohur në historinë e shkrimit letrar. Ajo ka krijuar një lloj të vacante strofe, e njohur si strofa safirike.

Anakreoni u lind ne Tejat e Azisë së Vogël, në gjysmën e dytë të shek.VI.
Të dhënat flasin për pesë librat e tij.

Klasifikimi më i shpeshtë i diskurseve poetike klasike është ai në: diskurse
elegjiake, jambike dhe melike.

Poezia elegjiake Ka qenë këngë vaji.

Nxitje për ndjenja luftarake, poezi sociale e politike, këngë e dashurisë etj.



Poezia jambike kishte karakter satirik.

Është e percjellë nga muzika, por s'është kënduar, ishte tip recitimi ritmik.



Melika zhvillimin më të madh e pati me poetët e Lesbosit.

Diskurst poetike klasifikohen ne monodike dhe korale.



ESKILI

Eskili ka shkruar rreth 90 tragjedi. Nga ky numër janë ruajtur vetëm 7:

Persët
Të shtatë kundër Tebës
Lutëset
Prometeu i mbërthyer dhe Orestia
Trilogji e përbërë nga Agamemnoni
Koeforët
Eumenidet

Për Aristotelin, tragjedia është imitim i veprimeve të larta. Tragjeditë klasike janë shkruar në vargje. Mendohet se Persët është vepra më e vjetër e Eskilit.

Sipas mitit, Prometeu vodhi zjarrin hyjnor dhe ua dhuroi njerëzve.

- Zeusi, kryeperëndi e Olimp, e dënoi, duke e mbërthyer në një shkëmb.

Prometeu i çliruar janë ruajtur vetëm disa fragmente. Prometeu zjarrsjellës mungon plotësisht.

- Nga kjo trilogji, është ruajtur vetëm pjesa Prometeu i Mbërthyer.

ARISTOFANI

Aristofani merret si komediografi më i njohur i kohës së tij dhe ndër me Të mirët e të gjitha kohërave, autori 50 pjesëve dramatike, 11 nga to mbijetuan.

Ndër komeditë e tij më të njohura janë:

Bretkosat	Arharnianet
Lisistrata	Princat
Retë	Paqja
Grerëzat	Zogjtë
Plutus	Gratë në festivalin e Demetrës

Në komedinë Retë, ai kthen vëmendjen drejt një njeriu të madh të kulturës dhe një mendimtari, si Sokrati.

Te një nga kryeveprat e tij, Bretkosat, ai flet për një jetë më tjetër dhe një figurë tragjike të asaj kohe, Euripidin.

Te Grerëzat, Aristofani i kthehet temës së tij të preferuar, shkatërrimit të Athinës.

ARISTOTELI

Poetika është vepra e parë teorike sistematike mbi letërsinë, e njohur në kulturën perëndimore.

Aristoteli Poetikën e ka menduar si teori të imitimit.

Për Aristotelin, poezia është imitim.

Për Aristotelin, tragjedia është imitimi një veprimi të lartë.

Me fatin e heroit tragjik lidhet funksioni i tragjedisë.

Poezinë dhe Historinë i dallon për nga objekti dhe mënyra e imitimit.

Ajo thurr ngjarjen sipas gjasës dhe personave u jep emra të shpikur.

Tragjedia dhe epopeja ndryshojnë për nga gjatësia dhe metri.

Tragjedia mund të flasë për gjëra të çuditshme, por jo për gjëra të cilat i pranon arsyeja.

LETËRSIA E MESJETËS

Në Mesjetë ose Kohë të Mesme nënkuptojmë kryesisht,periudhën ndërmjet shekujve V-XV.Si një kërkesë e kthimit në Antikitetin e vërtetë, si një kundërpeshë e kuptimeve kulturore e letrare të cilat ne sot i quajmë mesjetare. Rrjedhimisht, vetë fjala mesjetar, është bërë atribut përbuzës, sikurse edhe nocioni feudalizëm,i cili përdorej për tipizimin e Mesjetës, në kuptimin e rendit shoqëror.Mesjeta shihet dhe si periudha e vetëdijes moderne për një rilindje, qoftë të brendshme,shpirtërore në shek. XIV-XV.

Krijimet e tjera të njohura të Mesjetës janë:





Teatri mesjetar europian e ka zanafillën në celebrimin “dramaturgjik” të ritualit të Pashkëve dhe të Krishlindjeve. Pjesët e para mesjetare quhen mistere dhe rrëfejnë në mënyrë naive episode nga historia e shenjtoreve ose ilustrojnë parabola biblike. Teatri spanjoll në shek. XVII në historinë e letërsisë njihet si shekulli i artë spanjoll ose shekulli i barokut.

Kënga e Rolandit Është poema më e vjetër epike në frëngjisht.

Mendohet se dorëshkrimi i saj është përfunduar diku rreth viteve 1130-1170.

Ndër ciklet kryesore të këngëve, janë tri cikle:



Dante Aligieri

Dante Aligieri lindi në Firencë në vitin 1265, në një familje të aristokracisë së ulët, me pasuri jo të madhe. Emri i tij i vërtetë ishte Durante, ndërsa Dante ishte një lloj emri përkdhelës.

Shkroi komedinë hyjnore të tij në
dialektin fiorentin.



Arti në Stilnovo krijohet vetëm për
dashurinë.

Dante shkroi në latinisht dhe në italisht. Veprat e tij janë: në italisht- Jeta e re, Gostia, Rima, Lulja, Borxhi i dashurisë, Komedia hyjnore, në latinisht- Mbi Elokuencen vulgare, Monarkia, Epistula, Për ujin e tokën ,etj. Komedia hyjnore është kryevepra dhe shprehja më e lartë letrare e kulturës së Mesjetës.

Nisur nga koncepti i Trinisë, poema është ndarë në tre libra.

Secili nga ata paraqet një mbretëri të veçantë:

Secili libër ka 33 këngë.

Ferri ka 34 këngë.

Komedia përbëhet nga 100 këngë.

Beatricia ishte gruaja e adhruar nga Danteja gjatë jetës së tij.

E cila del simbol i dashurisë për Zotin, që mund të ndihmojë shpëtimin e njeriut.







